

REKOMANDIME

Për garantimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe gjithëpërfshirjes në arsim

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrim të kompetencave të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, veçanërisht nenit 32, pika 1, shkronjat “ë” dhe “f”, dhe në zbatim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, paraqet rekomandimet për fillimin e vitit shkollor 2026–2027 në sistemin arsimor parauniversitar.

E drejta për arsimim duhet të garantohet në mënyrë efektive, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse. Aksesit formal në shkollë nuk është i mjaftueshëm nëse nxënësit përballen me barrierë fizike, ekonomike, administrative, sociale apo diskriminuese që cenojnë pjesëmarrjen, vijueshmërinë dhe rezultatet e tyre. Ligji nr. 10221/2010, i ndryshuar, ndalon diskriminimin në arsim dhe vendos detyrime pozitive për institucionet përgjegjëse; ndërsa ligji nr. 69/2012, i ndryshuar, parashikon kujdes të posaçëm për kategori të veçanta nxënësish.

Praktika e Komisionerit dhe vlerësimet e organizmave ndërkombëtarë për Shqipërinë kanë evidentuar problematika që prekin veçanërisht fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara, vajzat, fëmijët në zonat rurale, fëmijët LGBTI dhe kategori të tjera në situata vulnerabiliteti. Për këtë arsye, nevojiten masa konkrete, të koordinuara dhe të monitorueshme, të përshtatura me nevojat e secilit grup.

KONSTATIME MBI PROBLEMATIKAT QË NDIKOJNË NË GARANTIMIN E BARAZISË NË ARSIM

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave ligjore dhe bazuar në praktikën e Komisionerit, monitorimet e zhvilluara dhe vlerësimet e organizmave ndërkombëtarë për Shqipërinë, janë evidentuar problematika dhe barrierë që ndikojnë në ushtrimin efektiv dhe në kushte të barabarta të së drejtës për arsimim. Këto problematika paraqiten më poshtë sipas fushave dhe kategorive ku kërkohet vëmendje e posaçme.

◆ Barazia gjinore dhe arsimimi i vajzave

Barazia gjinore në arsim kërkon jo vetëm akses dhe regjistrim të barabartë, por edhe mjedise të sigurt, mbrojtje nga dhuna dhe ngacmimi me bazë gjinore, eliminim të stereotipeve dhe mundësi të barabarta në orientimin arsimor e profesional. Vëmendje e veçantë kërkohet për vajzat romë dhe egjiptiane dhe për vajzat në zonat rurale, ku rreziku i braktisjes mund të jetë më i lartë.

◆ Arsimi parashkollor

Fëmijët në situata vulnerabiliteti mund të përballen me pengesa që në arsimin parashkollor. Përfshirja e hershme dhe masat lehtësuese për familjet në nevojë janë të rëndësishme për garantimin e mundësive të barabarta që në fillim të rrugëtimit arsimor.

◆ Fëmijët/nxënësit romë dhe egjiptianë

Praktika e Komisionerit dhe vlerësimet e GJEDNJ-së, CERD-it, ECRI-t dhe Komitetit Këshillimor të Konventës Kuadër evidentojnë vijimësinë e segregimit de facto, norma më të ulëta të përfundimit të arsimit dhe barrierat në regjistrim, transport, përfitimin e masave mbështetëse dhe aksesin digjital. Masat desegreguese duhet të prodhojnë integritet real dhe jo vetëm ndryshime administrative.

◆ Fëmijët/nxënësit e pakicave të tjera kombëtare

Zbatimi i të drejtave për mësimin e gjuhës amtare dhe njohjen e historisë e kulturës së pakicave duhet të jetë efektiv. Vëmendje kërkojnë disponueshmëria e mësuesve, cilësia dhe shpërndarja në kohë e teksteve, si dhe përfaqësimi i kulturës së pakicave në kurrikulë.

◆ Fëmijët/nxënësit LGBTI

Institucionet arsimore duhet të parandalojnë dhe trajtojnë diskriminimin, bullizmin, ngacmimin dhe gjuhën e urrejtjes për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, përmes mekanizmave të sigurt raportimi dhe stafit të trajnuar.

◆ Fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara

Pavarësisht kuadrit ligjor për arsimin gjithëpërfshirës, në praktikë vijojnë problematika lidhur me funksionimin në kohë të KMVA-ve, hartimin dhe zbatimin e Planeve Edukative Individuale, caktimin e mësuesve ndihmës, aksesueshmërinë, transportin dhe përshtatjet e arsyeshme, përfshirë gjatë provimeve kombëtare. Përfshirja në klasën e zakonshme duhet të mbetet parimi bazë.

◆ Fëmijët/nxënësit nga familje në kushte të vështira social-ekonomike

Gjendja ekonomike dhe shoqërore mund të krijojë ose përkeqësojë pabarazitë në arsim. Informimi i pamjaftueshëm dhe procedurat administrative për bursa, tekste falas, transport dhe masa të tjera mbështetëse mund të kufizojnë përfitimin e familjeve në nevojë, veçanërisht në zonat rurale dhe periferike.

◆ Fëmijët/nxënësit e ngujuar për shkak të gjakmarrjes

Ngujimi për shkak të gjakmarrjes kufizon rëndë të drejtën për arsimim. Institucionet duhet të garantojnë pa vonesë vijimësinë e arsimit përmes formave alternative të parashikuara nga ligji dhe një përgjigjeje të koordinuar për çdo fëmijë të prekur.

◆ Fëmijët/nxënësit në situatë rruge

Këta fëmijë përballen me rrezik të lartë mosregjistrimi, mungesash dhe braktisjeje. Nevojiten identifikim i hershëm, ndjekje individuale dhe bashkëpunim i qëndrueshëm ndërmjet shkollës, strukturave të mbrojtjes së fëmijës dhe shërbimeve sociale, me synim jo vetëm regjistrimin por edhe vijueshmërinë dhe riintegrimin e qëndrueshëm.

◆ Fëmijët/nxënësit refugjatë, azilkërkues ose migrantë

E drejta për arsimim duhet të garantohet pa diskriminim edhe për fëmijët e huaj dhe pa shtetësi. Përtej regjistrimit formal, kërkohen masa për mbështetjen gjuhësore, psikosociale dhe integrimin në procesin mësimor e në komunitetin shkollor.

◆ Fëmijët/nxënësit nga zonat rurale

Distanca nga shkolla, transporti, mungesa e mësuesve të kualifikuar, infrastruktura dhe akseset e kufizuara në teknologji mund të krijojnë pabarazi reale në ushtrimin e së drejtës për arsimim dhe, sipas rastit, të prodhojnë diskriminim të tërthortë për shkak të vendbanimit.

Për sa më sipër, në ushtrim të kompetencave ligjore dhe me qëllim forcimin e masave për garantimin e barazisë dhe parandalimin e diskriminimit në arsim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi paraqet këto

REKOMANDIME

Të gjitha institucionet, në përputhje me kompetencat e tyre, të marrin masat e nevojshme për garantimin efektiv, të barabartë dhe pa diskriminim të së drejtës për arsimim për të gjithë fëmijët dhe nxënësit.

◆ Masa të përgjithshme

- Zbatimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor e nënligjor, strategjive dhe planeve kombëtare që lidhen me barazinë, mosdiskriminimin dhe arsimin gjithëpërfshirës.
- Afishimin në çdo institucion arsimor, përfshirë arsimin profesional, të informacionit mbi ligjin nr. 10221/2010 dhe të drejtën e nxënësve e prindërve për t'iu drejtuar Komisionerit.
- Parashikimin e procedurave të qarta për raportimin, trajtimin dhe shqyrtimin brenda afateve ligjore të rasteve të diskriminimit, bullizmit, ngacmimit dhe gjuhës së urrejtjes.
- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit mësimor, drejtues dhe psikosocial mbi mosdiskriminimin, barazinë gjinore, racizmin, aftësinë e kufizuar, çështjet LGBTI dhe menaxhimin e diversitetit.
- Monitorimin e politikave dhe praktikave arsimore me qëllim identifikimin dhe korrigjimin e pabarazive ose situatave që mund të sjellin diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.
- Përmirësimin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të disagreguara, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të identifikuar pabarazitë në akses, vijueshmëri, përfundim dhe braktisje.

◆ Masa të posaçme për garantimin e barazisë dhe përfshirjes në arsim

Barazia gjinore dhe arsimimi i vajzave

- Sigurimin e mjediseve të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, me mekanizma konfidencialë raportimi dhe reagim efektiv ndaj dhunës, ngacmimit dhe diskriminimit me bazë gjinore.
- Trajnimin e stafit për identifikimin e stereotipeve gjinore dhe garantimin e mundësive të barabarta në vlerësim, orientim në karrierë, veprimtari jashtëshkollore dhe strukturat përfaqësuese të nxënësve.
- Identifikimin dhe adresimin në kohë të rasteve kur martesat e hershme/të detyruara ose faktorë të tjerë socialë rrezikojnë vijimin e arsimit të vajzave, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës.
- Garantimin e kushteve higjieno-sanitare të përshtatshme dhe nxitjen e vijimit të arsimit të vajzave, veçanërisht në zonat rurale dhe grupet vulnerabël.

Arsimi parashkollor

- Lehtësimin e aksesit dhe dhënien e përparësisë, sipas kuadrit ligjor në fuqi, fëmijëve nga familjet në nevojë dhe grupet e disavantazhuara.
- Identifikimin e hershëm të barrierave dhe nevojave mbështetëse, në mënyrë që përfshirja të fillojë që në arsimin parashkollor.

Fëmijët/nxënësit që u përkasin pakicave kombëtare

A. Akses, pjesëmarrja dhe përfshirja në arsim

- Garantimin e regjistrimit dhe vijimit të arsimit të detyrueshëm, pavarësisht pengesave që lidhen me dokumentacionin civil ose aksesin në e-Albania, duke siguruar asistencë të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunim institucional për zgjidhjen e tyre, me vëmendje të posaçme ndaj fëmijëve që përballen me barriera të tilla.
- Identifikimin proaktiv të fëmijëve jashtë sistemit ose në rrezik braktisjeje dhe monitorimin e mungesave dhe vijueshmërisë ndërmjet niveleve arsimore.
- Parandalimin dhe eliminimin e çdo forme segregimi ose përqendrimi de facto në institucionet arsimore, përfshirë rastet që prekin fëmijët romë dhe egjiptianë, përmes marrjes së masave efektive, ndër të tjera rishikimit të zonave të mbulimit dhe sigurimit të transportit kur është e nevojshme, me qëllim garantimin e integritetit real dhe jo vetëm të bashkimit administrativ.
- Ruajtjen dhe forcimin e masave mbështetëse, përfshirë transportin, tekstet dhe mjetet shkollore falas, bursat dhe format e “shansit të dytë”, duke shmangur heqjen e tyre pa alternativa efektive.
- Mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të disagreguara për regjistrimin, vijueshmërinë dhe përfundimin e arsimit, me qëllim evidentimin e pabarazive dhe ndërhyrjen e hershme për adresimin e tyre.

B. Gjuha, kultura dhe përmbajtja arsimore

- Garantimin efektiv të mësimin në gjuhën amtare dhe të njohjes së historisë e kulturës së pakicave kombëtare, aty ku kjo parashikohet nga legjislacioni.
- Garantimin e përfaqësimit të historisë, kulturës dhe kontributit të komuniteteve romë dhe egjiptiane, si dhe të pakicave të tjera kombëtare, në mjediset, përmbajtjet dhe aktivitetet shkollore, në përputhje me legjislacionin dhe standardet përkatëse.
- Monitorimin periodik nga strukturat arsimore të nevojave për mësues, tekste dhe materiale mësimore, si dhe të problematikave të tjera që pengojnë ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave.
- Marrjen e masave për përgatitjen dhe sigurimin e mësuesve të gjuhës romë aty ku ka nevojë, si dhe të mësuesve për mësimin në gjuhët e pakicave të tjera, sipas parashikimeve ligjore dhe nevojave të evidentuara.
- Përmirësimin e cilësisë dhe shpërndarjes në kohë të teksteve dhe materialeve mësimore, si dhe konsultimin me përfaqësuesit e komuniteteve përkatëse për çështjet që lidhen me kurrikulën.

Fëmijët/nxënësit LGBTI

- Zhvillimin e masave dhe moduleve specifike kundër bullizmit, ngacmimit dhe gjuhës së urrejtjes për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit.
- Sigurimin e kanaleve konfidenciale dhe të sigurta të raportimit, të njohura nga nxënësit dhe stafi.
- Trajnimin e stafit dhe trajtimin efektiv, pa vonesë, të çdo rasti të sinjalizuar të diskriminimit ose ngacmimit homofobik/transfobik.

Fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara

- Identifikimin dhe referimin e hershëm të nevojave që në arsimin parashkollor, si dhe funksionimin në kohë të KMVA-ve, hartimin e PEI-ve dhe caktimin e mësuesit ndihmës, në mënyrë që mbështetja të jetë e disponueshme që në fillim të vitit shkollor.
- Garantimin që mësuesit ndihmës të përmbushin kriteret ligjore dhe profesionale dhe që roli i tyre të mbështetëse përfshirjen në klasën e zakonshme, jo ndarjen e nxënësit.
- Formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave arsimore, sociale dhe shëndetësore për një mbështetje të koordinuar dhe të vazhdueshme.
- Sigurimin e aksesueshmërisë së mjediseve, informacionit dhe komunikimit dhe ofrimin e përshtatjes së arsyeshme sipas nevojave individuale; mohimi i saj përbën diskriminim sipas ligjit.
- Garantimin në kohë të përshtatjeve të nevojshme gjatë provimeve kombëtare dhe Maturës Shtetërore.
- Monitorimin e përfshirjes në klasat e zakonshme, ndërgjegjësimin e komunitetit shkollor dhe mbledhjen e të dhënave statistikore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Fëmijët/nxënësit nga familje në kushte të vështira social-ekonomike

- Identifikimin në kohë të nxënësve në vështirësi dhe koordinimin ndërmjet shkollave, njësive vendore dhe shërbimeve sociale për parandalimin e braktisjes dhe përjashtimit.
- Informimin e qartë dhe të aksesueshëm të familjeve mbi bursat, tekstet falas, transportin dhe masat e tjera mbështetëse.
- Thjeshtimin e procedurave dhe shmangien e barrierave administrative ose digjitale që mund të penalizojnë familjet në nevojë, si dhe krijimin e mekanizmave të qartë për trajtimin e ankesave dhe refuzimeve.

Fëmijët/nxënësit e ngujuar për shkak të gjakmarrjes

- Identifikimin e menjëhershëm dhe garantimin pa vonesë të vijimësisë së arsimit përmes formave të lejuara nga legjislacioni, përfshirë arsimin në distancë, me kohë të pjesshme ose në kushtet e shtëpisë.
- Sigurimin e mbështetjes arsimore, psikologjike dhe sociale dhe planifikimin e rikthimit gradual në sistemin e rregullt arsimor sapo kushtet ta lejojnë.

Fëmijët/nxënësit në situatë rruge

- Forcimin e mekanizmave të identifikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shkollës, strukturave të mbrojtjes së fëmijës, shërbimeve sociale, njësive vendore dhe organizatave të shoqërisë civile.
- Garantimin e regjistrimit pa u kushtëzuar nga adresa fikse dhe zbatimin e procedurave fleksibël për rikthimin dhe vijimin e arsimit.
- Monitorimin e vijueshmërisë dhe ofrimin e mbështetjes së përshtatur arsimore e sociale, me synim riintegrimin e qëndrueshëm dhe parandalimin e braktisjes.

Fëmijët/nxënësit nga zonat rurale

- Garantimin e transportit funksional dhe të sigurt për nxënësit që përballen me distanca të konsiderueshme nga shkolla.
- Marrjen e masave për plotësimin e nevojave për mësues të kualifikuar dhe nxitjen e qëndrueshmërisë së stafit pedagogjik në zonat rurale.

- Monitorimin dhe përmirësimin me përparësi të infrastrukturës, kushteve higjieno-sanitare dhe aksesit në teknologji e internet.
- Monitorimin e vijueshmërisë dhe rrezikut të braktisjes, si dhe informimin e familjeve mbi bursat, tekstet falas, transportin dhe masat e tjera mbështetëse.

Fëmijët/nxënësit refugjatë, azilkërkues ose migrantë

- Garantimin e aksesit të plotë, të barabartë dhe pa vonesë në arsimin e rregullt, pavarësisht statusit të qëndrimit apo vështirësive të dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Ofrimin e mbështetjes për mësimin e gjuhës shqipe dhe adresimin e nevojave arsimore, psikologjike e sociale gjatë integritit.
- Forcimin e koordinimit me njësitë vendore, shërbimet sociale, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe organizatat që mbështesin refugjatët, azilkërkuesit dhe migrantët.

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

Garantimi i së drejtës për arsimim në kushte të barabarta kërkon që detyrimet ligjore të përkthehen në masa konkrete, të zbatueshme dhe të qëndrueshme. Zbatimi efektiv i rekomandimeve të mësipërme, përmes bashkëpunimit ndërinstitutional dhe me vëmendje të posaçme ndaj nevojave dhe rrethanave të secilit fëmijë, është thelbësor për parandalimin e diskriminimit dhe forcimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, të aksesueshëm dhe të barabartë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të vijojë, në përputhje me kompetencat ligjore, monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për adresimin e problematikave që mund të cenojnë parimin e barazisë dhe ushtrimin efektiv të së drejtës për arsimim.

Rekomandimet dhe masat e evidentuara duhet të reflektohen në veprime konkrete në praktikë, me qëllim që çdo fëmijë të gëzojë mundësi reale dhe të barabarta për arsimim. Garantimi i një sistemi arsimor pa diskriminim dhe gjithëpërfshirës përbën jo vetëm një përgjegjësi institucionale, por edhe një investim të drejtpërdrejtë në të ardhmen e fëmijëve dhe të shoqërisë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju uron një fillim të mbarë dhe një vit shkollor 2026–2027 të suksesshëm, gjithëpërfshirës dhe me mundësi të barabarta për çdo fëmijë.

